



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës (në tekstin e mëtejme OMK), përmes Komisionit për edukimin e vazhdueshëm profesional të Odës së Mjekëve të Kosovës, duke u bazuar në dispozitat e Rregullores së këtij Komisioni, në lidhje me subvencionimin e aktiviteteve të veçanta të edukimit të vazhdueshëm profesional, me datë 15 mars 2023 shpall:

KONKURS PUBLIK PËR PËRKRAHJEN FINANCIARE TË AKTIVITETEVE TË VEÇANTA TË EVP

Hyrje

Oda e Mjekëve të Kosovës, përmes organeve të saj, respektivisht Komisionit për edukim të vazhdueshëm profesional, me qëllim të përkrahjes së zgjerimit dhe avansimit të edukimit të vazhdueshëm profesional, do të përkrahë financiarisht aktivitete, organizime dhe edukim profesional të cilat organizohen nga shoqatat profesionale.

Kjo përkrahje financiare do të realizohet sipas procedurës së konkurimit të shoqatave profesionale, dhe do të rrjedh nga buxheti i OMK dhe përkrahjes përmes projekteve të veçanta që mund të jenë të implementuara nga OMK por të përkrahura nga donatorët.

Subjektet e autorizuara për përkrahje financiare dhe kriteret për aplikim

Subjektet e autorizuara sipas kësaj rregulloreje, siç janë shoqatat profesionale, do të përkrahen për organizime të veçanta të edukimit të vazhdueshëm profesional, nën kushtet e përgjithshme dhe kushteve të veçanta që janë të përcaktuara me Rregulloren e KEVP, si në vijim:

Kushtet e përgjithshme si në vijim:

- Aktin e regjistrimit të shoqatës me të cilën dëshmohet se shoqata është e regjistruar me status të organizatës joqeveritare sipas legjislacionit në fuqi;
- Dëshmia për qëndrueshmërinë financiare;

- Deklarata e funksionalitetit – e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i shoqatës dhe anëtarët e bordit drejtues të shoqatës me të cilën bëhet deklarimi i funksionalitetit të shoqatës;
- Dëshmia se shoqatës nuk i është revokuar certifikata e aktivitetit apo programit të EVP-së në tre (3) vitet e fundit.

Kushtet e veçanta si në vijim:

- Elaborati profesional/shkencor me të cilin do të përshkruhet përmbajtja e aktivitetit të EVP-së;
- Lista e ligjëruesve dhe prezantimet me dokumentacionin përcjellës të ligjëruesve duke përfshirë CV-të të ligjëruesve në event; dhe
- Dokumenti i përshkrimit të impaktit të eventit nga aspekti praktik dhe multidisiplinar;

Informacione të tjera:

- Konkursi publik do të jetë i hapur në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e publikimit të tij;
- Aktiviteti për të cilin bëhet aplikimi duhet të mbahet jo më vonë se muaji i 11-të i vitit kalendarik në të cilin aplikohet;
- Dokumentacioni sipas kritereve të lartëcekura duhet të dorëzohet në ekzemplar fizik dhe në dokumente origjinale apo të noterizuara.
- Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në zyret e OMK, me adresë: QKUK, INSTITUTI A, KATI I III-TË, 10 000 – PRISHTINË RKS. Personi kontaktues: Mergime Krasniqi, nr. kontaktues 049/872-070.
- Afati i fundit për aplikim: 15 prill 2023, ora 16:00 (përfshirë dhe aplikimin online)
- Për çdo informatë shtesë luteni të kontaktoni në e-mail adresën zyrtare të Odës info@omk-rks.org dhe zyrtarit të Odës Liridon Beha liridon.beha@omk-rks.org nr.kontaktues 049/872182